



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 134, datë 30.09.2020

**PËR
MIRATIMIN E STATUTIT, MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT
DHE MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS,
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “INSIG JETË” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 21 dhe 57, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe bazuar në Rregulloren nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e statutit të shoqërisë së sigurimit “Insig Jetë” sh.a.**
- 2. Miratimin e emërimit të zj. Elvana Mino, si Administratore e shoqërisë së sigurimit “Insig Jetë” sh.a., për një periudhë 2-vjeçare, deri më datë 21.06.2022.**
- 3. Miratimin e emërimit të z. Vasil Pilo si kryetar, zj. Anila Ibraj si anëtare dhe z. Forcim Kola si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit “Insig Jetë” sh.a., për një periudhë 3-vjeçare, deri më datë 08.06.2023.**
- 4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**